



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 03.03.2023
PRIMLJENO:
Nr. No. Pr. 02 / 117



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/ _____

Datë: 01.03.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19, nenit 29 paragrafi I pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të mbajtur me datë: 28.02.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR FAMILJE TË DËSHMORËVE INVALIDË DHE VETERANË TË LUFTËS SË UÇK-SË DHE MARTIR TË LUFTËS PËR VITIN 2022

1. Miratohet Raporti i punës nr.02/85 datë 13.02.2023 i Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Vetëranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martir të luftës në Komunën e Malishevës për vitin 2022.
2. Raporti i punës përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e organizuara për vitin 2022 nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Vetëranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martir të luftës.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Raporti i punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Vetëranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martir të luftës për vitin 2022.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Vetëranë të luftës së UÇK-së, si dhe Martir të luftës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autëritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA MALISHEVË/ OPŠTINA MALIŠEVO/ MUNICIPALITY OF MALISHEVË

KOMITETI PËR FAMILJE TË DËSHMOREVE, INVALIDË, VETERANË TË LUFTËS SË UÇK-SË SI DHE MARTIRË TË LUFTËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022 TË KFDIVLUÇKML

Komiteti për Familje të Dëshmoreve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës.

Në mbledhjen e fundit të mbajtur me datë: Komitei për Familje të Dëshmoreve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës diskutuar dhe ka miratuar Raportin vjeor të punës së këtij Komitei.

Pas Planit të Veprimit që njëherit është Platforma e Komitetit, i cili duhet të përmbushet në hollësi në faza të caktuara kohore. Raporti vjetor i Punës së Këtij Komitei është po ashtu dokumenti më i rëndësishëm ku pasqyrohen aktivitetet dhe puna si dhe përmbushja e Planit të veprimit të Komitetit.

Komitei FDIVLUÇKML është themeluar nga Kuvendi Komunal në Malishevë, me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Komitei si çdo herë tjetër ka bërë përpjekje të vazhdueshme që veprimtarinë e vet ta zhvilloi në bazë të këtij Plani.

Raporti vjetor i Punës së Komitetit i prezantuar më poshtë pasqyron në mënyrë të detajuar punën dhe aktivitetet tona si grup.

PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 13/02/2023
PRIMI: 02/85



Aktivitetet e realizuara të Komitetit FDIVLUÇKML gjatë vitit 2022.

Muaji	Aktiviteti	Çështjet e diskutuara	Pjesëmarrësit	Përfundimet	Komente shitesë
Maj	Mbledhja e parë e vitit, mbajtur më: 30 maj 2022.	- Mbledhja e parë e Komitetit u mbajtë me datë: 30.05.2022 të cilën e udhëheqi Kryesuesi i Kuvendit, z. Argjend Thaçi. - Me të vetmen pikë të rendit të ditës Konstituimi i Komitetit dhe zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit. - Anëtarët e Komitetit me mënyrë unanime zgjedhën Kryesues të Komitetit z. Ilaz Krasniqi.	- Kryesues i Kuvendit, z. Argjend Thaçi, Astrit Sertolli, Sami Hoti, Bedri Kryeziu, Ilaz Krasniqi, Egrem Morina. - Zyrtarja për informim.	Konstituimi i Komitetit dhe Zgjedhja e Kryesuesit.	
Qershor	Mbledhja e dytë e vitit, mbajtur më: 29 Qershor 2022.	- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. - Diskutim rreth hartimit të Planit të Punës së Komitetit për vitin 2022. - Të ndryshme	Ilaz Krasniqi, Astrit Sertolli, Sami Hoti, Bedri Kryeziu, Egrem Morina.	Në këtë mbledhje anëtarët e Komitetit diskutuan rreth Hartimit të planit të Punës për vitin 2022.	

			• Secili anëtar i Komitetit ka dhënë kontributin e tij rreth përgatitjes së Planit të Punës për Vitin 2022.	
Korrik Mbledhja e tretë e mbajtur 12 korrik 2022.	• Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjesë së dytë. • Miratimi i Planit të Punës për vitin 2022. • Të ndryshme.	• Ilaz Krasniqi, Egrem Morina, Bedri Kryeziu.	Komiteti ka diskutuar Draft Planin e Punës për vitin 2022. Edhe pse me vonesë pasi që Komiteti është themeluar me vonesë nga ana e Kuvendit Komunal, megjithatë në Planin e Punës janë paraqitur një varg aktivitësh të cilat	Anëtarët e Komitetit shprehën shqetësimin e tyre rreth mungesës së procesverbaleve nga mbledhjet paraprake. Mungesa e procesverbaleve po e vështirëson punën e Komitetit për arsye se nuk po evidentohen diskutimet dhe

				do të realizohen gjatë muajve në vijim. Komiteti në fund të mbledhjes ka miratuar Planin e Punës për vitin 2022.	planet paraprake dhe nuk po ruhet një vazhdimësi e punës nga takimet.
Tetor	Mbledhja e katër e Komitetit, mbajtur më 24 tetor 2022.	- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. - Diskutim rreth organizimit të festës së 28 Nëntorit Ditës së Flamurit. - Takim me Kryetarin e familjeve të Dëshmorëve, z. Sinan Gegaj. - Të ndryshme.	Pesë anëtarë të Komitetit.	Anëtarët e Komitetit diskutuan rreth organizimit të festës së 28 Nëntorit Ditës së Flamurit. Organizimi i nderimeve për Dëshmorët në Komunën tonë, si dhe homazhe nderimi në Kompleksin Memorial të	Një vërejtje nga Kryesuesi i Komiteti për Kryetarin e Shoqatës së familjeve të Dëshmorëve lidhur me listën e Dëshmorëve. Kryesuesi i Komitetit kërkoi sqarim, pse shoqata nuk e posedon listën e Dëshmorëve të

			Jasharajve në Prekaz. Komiteti gjatë takimit me Kryetarin e Shokatës së familjeve të Dëshmorëve, kërkoi nga përfaqësuesi i kësaj shoqate, një njoftim lidhur me gjendjen aktuale të familjeve të Dëshmorëve në komunën tonë, vëshirësitë dhe nevojat me të cilat ata ballafaqohen.	radhitur sipas dritës së rënies së tyre? Edhe pse kjo kërkesë ishte parqitur edhe mandatin e kaluar, por që nga Shoqata nuk është marrë fare në konsideratë. Përgjigjia e kryetarit të Shokatës, lidhur me këtë çështje ishte se Shoqata nuk ka një listë të re. Ndërsa emrat e rinjë të “Dëshmorëve të pasfhtës” figurojnë në këtë listë, pasi që ata statusin e Dëshmorit e kanë marrë nga një komision i
--	--	--	--	--

				nënshtkuar nga Agim Çeku
	Mbledhja e pestë e Komitetit, mbajtur më 21. 12. 2022.	- Shqyrtimi dhe miratimi i processverbalit nga mbledhja e kaluar. - Diskutim rreth ditës së veteranit 30 dhjetor 2022 si dhe takim me Kryetarin e OVL-UÇK z. Metush Kryeziu. - Të ndryshme.	- Anëtarët e Komitetit: Ilaz Krasniqi, Astrit Sertolli, Egrem Morina dhe Bedri Kryeziu. - Zyrtarja për informim.	Diskutimet u bënë rreth përgatitjes së Planit të Punës për vitin në vijim.
Dhjetor			Anëtarët propozuan që brenda në Plan të futen edhe kërkesat e OVL- UÇK, që kanë të bëjnë me shtimin e 2 anëtarëve të rinj në këtë komitet dhe nga 5 anëtar sa ka aktualisht, Komiteti ti ketë 7 anëtarë.	
			Po ashtu u diskutua edhe rreth mundësisë që Kryesuesi i Komitetit, Ilaz	

				Krasniqi ti drejtohet me shkresë zyrtare Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës, që OVL e UÇK-së ta kenë në shfrytëzim një veturë zyrtare që do t'ju shërbente përfaqësuesëve të shoqatës për nevojat dhe aktivitetet e tyre në terren.	
--	--	--	--	---	--

	• 30 Dhjetori është Dita e Veteranëve të Luftës. Kryetarja e Komitetit (KFDIVM), Ilaz Krasniqi njoftoj Kryetarin e Veteranëve, Metush Kryeziun, me punën e Komitetit gjatë vitit 2022.		Bashkëpunim ndërmjet Komitetit dhe Shoqatës në jetësimin e kërkesave të përafërta.	Për kundër mundësive finansiare për të kurorëzuar projektet e parapara, këto dy organizma të vlerave të luftës kanë një përkushim të madh për të gjetur alternativa tjera...
--	--	--	---	---

Rekomandimet e dala nga Komiteti:

1. Plotësimi i Komitetit FDI VLUÇKML me dy anëtarë, ku njëri duhet të jetë nga OVL e UÇK-së.
2. Funksionalizimi sa më parë i objektit të organizatave të dala nga lufta.
3. Mundësimi nga ana e qeverisjes komunale që OVL e UÇK-së dega në Malishevë ta ketë në shfrytëzim një veturë zyrtare për nevojat e OVL-së.
4. Kuvendi Komunal të ndajë buxhet vjetor për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve, lapidarëve dhe memorialeve të Dëshmorëve dhe martirëve të luftës.
5. Kuvendi Komunal ta fusë në kalendarin e shënimit të ngjarjeve historike edhe masakrën e Lapqevës ku janë vrarë dhe masakruar 12 qytetarë, prej tyre 2 fëmijë të mitur.
6. Për Kuvendin Komunal dhe Komisionin për emerimin e rrugëve të reja, që në listën e emrimeve të rrugëve të përfshihen emrat e dëshmorëve të cilët deri me tani nuk figurojnë si emra në asnjërin prej rrugëve dhe institucioneve publike në komunën tonë.

Malishevë:

Më: 07/ 02/ 2023

